

V E N D I M
Nr. 377, datë 31.5.2001

**PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” NË
MARËDHËNIET NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 24 e 31 të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një shteti tjetër ose një organizate ndërkombëtare, ndërmjet ministrive e institucioneve qendrore të vendit me homologët e tyre të vendeve të tjera, me të cilët janë lidhur marrëveshje ndërkombëtare, të bëhet në përputhje me këto marrëveshje.

2. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) pranë Këshillit të Ministrave është Autoriteti i Sigurimit Kombëtar në fushën e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” me NATON-n, me shtetet dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

3. Para nënshkrimit të një marrëveshjeje, e cila përmban shkëmbim të informacionit të klasifikuar, duhet që:

institucioni shtetëror shqiptar, që do të jetë palë në marrëveshje, të marrë më parë mendimin e DSIK-së;

pëlqimi për lidhjen e marrëveshjes për shkëmbim informacioni të klasifikuar jepet pasi Autoriteti i Sigurimit Kombëtar të vendit, palë në marrëveshje, të ketë dorëzuar te DSIK-ja garancinë se institucioni, që do të jetë palë në marrëveshje, do të ruajë informacionin e klasifikuar sipas standardit të kërkuar.

4. DSIK-ja u kërkon ministrive e institucioneve që lidhen me sigurimin kombëtar, rendin publik dhe institucioneve të tjera, që e gjykon të nevojshme, informacionin për besueshmërinë, veprimtarinë dhe qëndrimin ndaj vendit tonë të ministrisë apo të institucionit të shtetit palë në marrëveshje.

5. Certifikata e sigurisë e lëshuar nga Autoriteti i Sigurimit Kombëtar të shtetit palë në marrëveshje për një person apo organizëm, për të patur akses në informacionin e klasifikuar është e vlefshme vetëm kur është lidhur një marrëveshje ndërkombëtare.

6. Për ministrinë dhe institucionet qendrore të vendit tonë, që kanë lidhur ose do të lidhin një marrëveshje ndërkombëtare me homologët e tyre të huaj për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, DSIK-ja lëshon “Çertifikatë sigurie”. Certifikata e sigurisë lëshohet për një periudhë të nevojshme kohe, për aq sa kërkohet në marrëveshje dhe në bazë të vlerësimit të kushteve të sigurimit të informacionit të klasifikuar.

7. DSIK-ja nuk do të lejojë akses (pra t’u japë të drejtë njohjeje) personave të tretë për informacionin e klasifikuar, pa miratimin e Autoritetit të Sigurimit Kombëtar të informacionit të klasifikuar të vendit palë në marrëveshje.

8. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar ndërmjet NATO-s dhe Republikës së Shqipërisë do të drejtohet nga DSIK-ja. Informacioni i klasifikuar i NATO-s për Shqipërinë, për ministrinë, për institucionet qendrore dhe anasjelltas dërgohet në zyrën e Regjistrisë Shtetërore (Qendror) të informacionit të klasifikuar, e cila ndodhet në DSIK, pranë Këshillit të Ministrave. Kjo zyrë bën regjistrimin, shpërndarjen dhe dërgimin e informacionit tek i adresuari.

9. Në Ministrinë e Mbrojtjes, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në Ministrinë e Rëndit Publik, në Misionin e Shqipërisë në NATO dhe në ministri e institucione të tjera qendrore, që kanë të bëjnë me informacionin e klasifikuar të NATO-s krijohet nënregjistri i informacionit të klasifikuar, i cili administron informacionin e klasifikuar që merr DSIK-ja.

Nënregjistri për administrimin e informacionit të klasifikuar zbaton rregulla të njëjta me ato të Regjistrisë Shtetërore (Qendror).

10. DSIK-ja dhe Autoriteti i Sigurimit Kombëtar të shtetit palë në marrëveshje, në përputhje me marrëveshjen ndërkombëtare që kanë lidhur, kanë të drejtë të ushtrojnë kontrolle për mbrojtjen dhe

sigurimin e informacionit të klasifikuar në vendet respektive.

11. Për rastet e publikimit apo të njohjes nga persona të paaautorizuar të informacionit të klasifikuar, si dhe për rastet e vjedhjes, dëmtimit, shkatërrimit, humbjes, shkeljes së rregullave të sigurimit, etj. njoftohet, menjëherë, DISK-ja dhe Autoriteti i Sigurimit Kombëtar i shtetit palë në marrëveshje.

12. Për marrëveshjet dhe protokollet teknike të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, DSIK-ja ka të drejtë të ushtrojë kontrolle për mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer.

13. Ministritë dhe institucionet qendrore janë të detyruara që një kopje të marrëveshjes për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar t'ia dërgojnë DSIK-së.

14. Ngarkohen titullarët e ministrive, institucioneve qendrore dhe DSIK-se për zbatimin e këtij vendimi.

15. Përfshihen nga zbatimi i këtij vendimi shërbimet informative brenda vendit, të cilat, në marrëdhënie me shërbimet e huaja partnere, zbatojnë procedurat për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, sipas marrëveshjes që kanë lidhur.

16. Vendimi nr.228, datë 4.4.1998 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e Autoritetit Kombëtar për shkëmbimin e informacionit me NATO-n” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta